



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2020

**Lënda:       Përgjigje kërkesë për informacion**

\_\_\_\_\_

**e.mail:** \_\_\_\_\_

Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 25.08.2020, drejtuar Bashkisë Shkodër me e.mail dhe regjistruar me nr.11971 prot., datë 25.08.2020, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion për furnizimin me ujë për shkollat dhe kopshtet në Bashkinë Shkodër, ju bëjmë me dije se:

Në Bashkinë Shkodër, funksionojnë 145 objekte të arsimit bazë dhe parashkollor. Nga këto, 87 janë shkolla të arsimit bazë, nga të cilat 28 në qytet dhe 59 në njësitë administrative. Bashkangjitur, do të keni emërtimet e shkollave, kopshteve dhe vendodhjet e tyre.

Furnizimi me ujë i shkollave dhe kopshteve, kryhet rregullisht.

Në ato shkolla dhe kopshte, ku ka probleme me furnizimin me ujë, është bërë e mundur hapja e 30 puseve. Në të gjitha ambjentet e shkollave, ka përfunduar procesi i dezinfektimit dhe deratifikimit.

Për më shumë informacion, mund të klikoni në [http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/arsimi\\_baze\\_perfshire\\_arsimin\\_parashkollor\\_2895\\_3172.pdf](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/arsimi_baze_perfshire_arsimin_parashkollor_2895_3172.pdf), si dhe në <https://buxheti.info/shkoder/> tek zëri shpenzime/arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.

Duke ju uruar mbarëvajtje në punë.